

URDHËRESË
Nr.9. datë 16.11.1990

PËR KONTROLL-REVIZIONIN EKONOMIKO-FINANCIAR

Për forcimin e mëtejshëm të kontrollit shtetëror në zbatimin e ligjshmërisë financiare, Këshilli i Ministrave nxjerr këtë

URDHËRESË

Neni 1

Kontroll-revizioni ekonomik-financiar është pjesë përbërëse e kontrollit të përgjithshëm shtetëror dhe ka për objekt veprimtarinë ekonomik-financiare, ruajtjen dhe administrimin e pronës shtetërore, zbatimin e ligjshmërisë financiare, përdorimin racional dhe sipas qëllimeve të caktuara të fondeve financiare e të vlerave materiale e monetare. Ai ndikon në realizimin e treguesve të planit, të kostos, të pagave e të treguesve të tjerë financiarë.

Neni 2

Kontroll-revizioni ekonomik-financiar ushtrohet nga organet e specializuara, që janë:

- a) Degët e kontrollit ose kontrollor-revizori në ndërmarrje e institucione.
- b) Qendrat e informatikës ekonomike për disa elemente të kontroll-revizionit ekonomik-financiar.
- c) Seksionet e kontroll-revizionit në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të rajoneve të organizuara më vete si dhe degët e kontroll-revizionit në njësitë e bashkuara ushtarake.
- ç) Drejtoritë ose degët e kontroll-revizionit në ministrinë e institucionet e tjera qendrore dhe në organet e tyre vartëse.
- d) Drejtoria e kontroll-revizionit dhe drejtoria ushtarake në Ministrinë e Financave.

Neni 3

Dega e kontrollit ose kontrollor-revizori varet drejtpërdrejt nga drejtuesi i ndërmarrjes dhe i institucionit.

Në ndërmarrje e në institucione me veprimtari ekonomik-financiare të vogël, me pëlqimin e organeve nga varen drejtpërdrejt, mund të mos vendosen degë kontrolli ose kontrollorë-revizorë dhe kontroll-revizionin do t'ua ushtrojnë këto organe.

Neni 4

Ndërmarrjet, institucionet, njësitë e repartet ushtarake përgjigjen për kontroll-revizionin ekonomik-financiar të tyre, duke përfshirë njësitë me drejtim ekonomik të brendshëm, si dhe kantieret, fabrikat, degët, sektorët etj.

Dega e kontrollit ose kontrollor-revizori kanë për detyrë të kontrollojnë:

- a) Saktësinë e realizimit të treguesve të prodhimit e të shpërndarjes, të kostos e të rezultatit financiar.
- b) Respektimin e nomratiave të harxhimit të vlerave materiale, dëmtimet, skarcitetet, respektimin e kontratave, mbështetjen ligjore e saktësinë e llogaritjes dhe zbatimin e rregullave në fushën e pagave e të shpërblimeve.
- c) Saktësinë e dokumenteve të nevojshme për adminjstirmin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, si dhe organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
- ç) Krijimin e përdorimin sipas planit e me efektivitet të fondeve monetare.
- d) Zbatimin e disiplinës financiare dhe përdorimin e vlerave materiale e monetare sipas qëllimeve të caktuara.

dh) Funksionimin e kontrollit të brendshëm të degëve të tjera dhe të njësive organizative vartëse në çështjet ekonomiko-financiare. Ato revizionojnë edhe llogarinë e sigurimeve shoqërore-shtetërore dhe veprimet e agjencive të kursimit.

Neni 5

Qendrat e informatikës ekonomike ushtrojnë kontroll-revizion financiar për zbatimin e rregullave e të ligjshmërisë së dokumentacionit, saktësinë e evidencës kontabël dhe informacionit të ndërmarrjeve e të institucioneve.

Organet e tjer të kontroll-revizionit ekonomiko-financiar të specializuara nuk janë të detyruara të ushtrojnë kontroll-revizion nëd rejtimit që janë objekt kontrolli i qendrave të informatikës ekonomike.

Neni 6

Ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe njësiutë e bashkuara ushtarake përgjigjen për drejtimin metodologjik, orgnizimin dhe kryerjen me afat e me cilësi të kontroll-revizioneve në shkallë sistemi, kurse komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e rajoneve në shkallë rrethi e rajoni. Këto organe kanë për detyrë të kryejnë kontroll-revizion ekonomiko-financiar në ndërmarrje, institucionet, repartet ushtarake e në organet e punëve të brendshme, sipas vartësisë së drejtëpërdrejtë.

Ministritë e institucionet e tjera qendrore kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll-revizione ekonomiko-financiare edhe në ndërmarrjet e institucionet e sistemit të tyre, që varen nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, Këtë të drejtë e kanë edhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e rajoneve për ndërmarrjet e institucionet që nuk i kanë në vartësi, por që ushtrojnë veprimtarinë brenda rrethit ose rajonit, përveç reparteve dhe uzinave ushtarake, organeve të punëve të brendshme dhe të rezervës shtetërore.

Organet e kontroll-revizionit të tyre kanë për detyrë:

a) Të kontrollojnë treguesit ekonomiko-financiarë, si e ardhura neto e centralizuar, ajo e ndërmarrjet dhe vetëfinancimin e saj, si dhe saktësinë e rezultatit ekonomik.

b) Gjatë ushtrimit të kontrollit analizojnë veprimtarinë ekonomiko-financiare për zbulimin e rezervave të brendshme në përdorimin me efektivitet të mjeteve të punës, të lëndëve të para e të materialeve e të fondit të pagave, në shfrytëzimin e kapaciteve prodhuese e në kursimin e fondeve, të mjeteve etj.

c) Të kontrollojnë efektivitetin e përdorimit të mjeteve kryesore, zbatimin e kriterëve në fushën e stimuljeve materialë, si dhe zbatimin e metodologjisë dhe saktësinë e kontabilitetit.

ç) Të kontrollojnë veprimtarinë e organeve të kontroll-revizionit ekonomiko-financiar në ndërmarrjet e në institucionet.

d) Të kryejnë kontrolle tematike e të befasishme për probleme të rëndësishme në shkallë dege, ekonomike ose rrethi.

Seksionet e kontroll-revizionit në komitete ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të rajoneve, kanë për detyrë të kontrollojnë në kooperativa bujqësore, jo më pak se një herë në vit, zbatimin e marrëdhënieve finaqnciare me shtetin, kurse kur kërkohet prej tyre, ushtrojnë kontrooll-revizion ekonomik-financiar. Në raste të tilla mund të kryejë kontroll-revizion ekonomiko-financiar edhe Ministria e Bujqësisë.

Seksionet e kontroll-revizionit në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të rajoneve kanë të drejtë të kontrollojnë veprimtarinë financiare të kooperativave të artizanatit, si dhe respektimin e saktësinë e marrëdhënieve të tyre me shtetin.

Neni 7

Ministria e financave përgjigjet për mbarëvajtjen e punës së kontroll-revizionit ekonomiko-financiar në të gjithë vendin dhe ka për detyrë:

a) Të kontrollojë punën e organeve të kontroll-revizionit ekonomiko-financiar në ministritë e institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të rajoneve, njësitë e bashkuara, ndërmarrjet, institucionet, njësitë e repartet ushtarake dhe organet e punëve të

brendshme, si dhe ka të drejtë të kryejë kontroll-revizione në gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të vendit.

b) Të drejtojë metodologjikisht kontroll-revizionin ekonomiko-financiar në gjithë vendin, që përfshin oranizimin e kontroll-revizionit, hartimin e përsosjen e metodikave, përpunimin dhe përgjithësimin e përvojës, si dhe bashkërendimin e punës me organet e tjera shtetërore e organizatat shoqërore.

Drejtoria e kontroll-revizionit e Ministrisë së Financave ka të drejtë të kontrollojë veprimtarinë financiare të kooperativave të artizanatit, si dhe respektimin e saktësinë e marrëdhënieve të tyre me shtetin.

Neni 8

Kontroll-revizionet ekonomiko-financiare të përgjithshme në formë të plotë ose me të zgjedhur ushtrohen jo më pak se një herë në vit dhe në bazë të planit vjetor.

Ndërmarrjet, institucionet, njësitë dhe repartet ushtarake kontroll-revizionin ekonomiko-financiar në qendrën e tyre mund ta ushtrojnë edhe pjesë-pjesë, por me kusht që e gjithë veprimtaria ekonomiko-financiare e tyre të revizionohet brenda vitit.

Ministria e Punëve të Jashtme, në objektet që kanë veprimtari financiare të vogël, kontroll-revizionin ekonomiko-financiar e kryejnë një herë në dy vjet.

Kontroll-revizioni ekonomiko-financiar mund të ushtrohet në organizatat shoqërore, kur kërkohet prej tyre.

Neni 9

Organet e kontroll-revizionit ekonomiko-financiar kanë këto të drejta kryesore:

a) Kërkojnë nga personi që kontrollohet, plane, dokumente, të dhëna e sqarime për çështjet që lidhen me ushtrimin e kontroll-revizionit ekonomiko-financiar, duke përfshirë edhe të dhënat e kontrolleve tekniko-ekonomike të kryera nga organet e tjera.

b) Marrin dokumente për sigurimin e provave, kundrejt vërtetimeve që lëshojnë kontrollorë-revizorët, djhe vulosin arka, magazina, dokumente etj., si dhe marrin deklarime që lidhen me çështjet që kontrollohen.

c) Kërkojnë të dhëna e kopje të dokumenteve të ndërmarrjeve, institucioneve e organizatave të tjera për veprimet dhe likuidimet që kanë lidhje me kontroll-revizionin që ushtrohet, pavarësisht nga vartësia.

ç) Aktivizojnë në kontroll-revizione punonjës të financës dhe specialistë të ndryshëm e ekspertë, me miratimin e titullarit të organit të kontroll-revizionit.

d) Marrin masa në vend për ndreqjen e të metave dhe vendosjen e rregullit, lënë detyra, kur nuk kanë mundësi që ato të zgjidhen menjëherë, kërkojnë marrjen e masave administrative, disiplinore e materiale për shkeljet e shkaktuara dhe në raste të veçanta, kur aktet e kryera formojnë vepër penale, bëjnë kallëzime në organet e hetuesisë.

Drejtuesit e organeve të kontroll-revizionit ekonomiko-financiarë dhe kontrollorë-revizorët në ndërmarrje e institucione kanë të drejtë të pezullojnë veprimet që bien ndesh me dispozitat në fuqi, gjer në shqyrtimin e tyre nga organi përkatës.

Neni 10

Për kontroll-revizionet ekonomiko-financiare të ushtruara nxirren përfundime dhe u bëhen të njohura kolektivave punonjës.

Për çështje të rëndësishme që dalin, organet e kontroll-revizionit i paraqitin përfundimet titullarëve të tyre. Në këto raste seksionet e kontroll-revizionit të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të rajoneve u dërgojnë përfundimet edhe ministrive e institucioneve të tjera qendrore për objektet e sistemit të tyre të kontrolluara. Organet e kontroll-revizionit u dërgojnë përgjithësimet ose përfundime për objekte të veçanta edhe Ministrisë së Financave dhe, kur janë të një

rëndësie të veçantë, edhe Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Për problemet që dalin gjatë ushtrimit të kontroll-revizionit, hartohet akti i kontroll-revizionit ekonomiko-financiar dhe, kur zbulohen dëmtime, mungesa, shkelje të disiplinës financiare e shkelje të tjera, mbahet procesverbali i veçantë me shkaktarët.

Akti i kontrollit nënshkruhet nga të kontrolluarit brend 3 ditëve nga marrja në dorëzim, procesverbalet nënshkruhen brenda 24 orëve, kurse aktet e tjera që anë lidhje me prova të veçanta, nënshkruhen menjëherë, kur personat që kontrollohen kanë vërejtje, bëjnë shënimet përkatëse.

Neni 12

Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore në shkallë sistemi, kryetarët e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e të rajoneve në shkallë rrethi e rajoni dhe drejtuesit e ndërmarrjeve, institucioneve dhe të njëjstëve e reparteve ushtarake, në mbështetje të materialeve që u paraqitën, kanë për detyrë të bëjnë shqyrtimin dhe të nxjerrin urdhra e udhëzime brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të tyre.

Kur organet e kontroll-revizionit nuk janë të një mendimi për zgjidhjen e çështjeve të veçanta me organet që i shqyrtojnë, këto çështje i parashtrohen për zgjidhje organit më të lartë.

Neni 13

Punonjësit e ndërmarrjeve ose të institucioneve ku ushtrohet kontrolli u japin ndihmë organeve të kontroll-revizionit ekonomiko-financiar me iniciativë dhe kur kjo u kërkohet.

Kontrollorë-revizorët vërtetojnë qenien e tyre në këtë detyrë me anën e librezës së veçantë, të lëshuar nga titullari.

Neni 14

Kontrollorë-revizorët dhe personat e tjerë të aktivizuar mbajnë përgjegjësi, sipas rastit, disiplinore ose penale për vërtetësinë dhe saktësinë e rezultateve të nxjerra, për moszbatimin e detyrave të caktuara në programin e punës, si dhe për moskryerjen e tij në përputhje me kërkesat e metodikave përkatëse për kontroll-revizionin ekonomiko-financiar.

Neni 15

Dispozitat e kësaj urdhërese u rekomandohen për zbatim edhe kooperativave bujqësore.

Neni 16

Urdhëresa nr.1, datë 19.6.1987 “Për kontroll-revizionin ekonomiko-financiar”, shfuqizohet.

Neni 17

Kjo urdhëresë hyn në fuqi më 1.1.1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Adil Çarçani